



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. ____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

VENDIM

Nr. 144, datë 28.03.2023

PËR

**FILLIMIN E PROCEDURËS SË PËRSHPEJTUAR TË DETYRUAR TË
VLERËSIMIT ETIK DHE PROFESIONAL, VITI KALENDARIK 2022, PËR
GJYQTARËT {...}, {...}, {...} DHE {...}**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenin 147/a, pika 1, shkronjat a) dhe ë) të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 85 e vijues të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nenin 61, pika 1, nenin 63 dhe nenin 86, shkronja dh), të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, Vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 263 datë 21.11.2019 “Për miratimin e rregullave plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve” dhe vendimin nr.77, datë 13.02.2023 “Për miratimin e listës së gjyqtarëve që kanë ose mund të kenë dy vlerësime, një vlerësim, si dhe të gjyqtarëve që nuk kanë e nuk mund të kenë asnjë vlerësim, për efekt të kandidimit në procedurat e lëvizjeve paralele në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë e Durrës, të shpallura me vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 11; 12; 13; 14; 15; 16; 17; 18; 19; 20; 21; 22; 23 dhe 24, datë 18.01.2023”, me propozim të Komisionit të Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale dhe mbas shortit të realizuar,

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurës së përshpejtuar të detyruar të vlerësimit etik dhe profesional viti kalendarik 2022, për gjyqtarët znj. {...}, z. {...}, z. {...} dhe z. {...}.
2. Caktimin e relatorit dhe nëpunësit përgjegjës për vlerësimin për secilin gjyqtar, si më poshtë:
 - Për gjyqtarin z. {...} - Relatore znj. Irena Plaku - Nëpunës përgjegjës për vlerësimin znj. Gilda Hoxha.
 - Për gjyqtarin z. {...} - Relatore znj. Brikena Ukperaj - Nëpunës përgjegjës për vlerësimin znj. Gilda Hoxha.
 - Për gjyqtaren znj. {...} - Relator znj. Brikena Ukperaj - Nëpunës përgjegjës për vlerësimin znj. Esmerilda Habili.
 - Për gjyqtarin z. {...} - Relatore znj. Yllka Rupa - Nëpunës përgjegjës për vlerësimin znj. Esmerilda Habili.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

{...}

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR